

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës
01 Nr. _____/2026
Datë:31.03.2026

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe nenin 8.1 dhe 14 të Rregullores (QRK) numër 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërtimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të Arsimit Prauniversitar në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2026, pas diskutimit lidhur me pikën e 5 të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për pozitat Drejtor të IEAA-AP në Komunën e Gjakovës, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa nga Drejtoria për Arsim për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për pozitat Drejtor të IEAA-AP në Komunën e Gjakovës.
2. Anëtarët e emëruar nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës të propozuar nga Drejtoria për Arsim janë :
 1. z. Zymber Berisha, Udhëheqës i Sektorit për Arsim në Komunën e Gjakovës, kryesues i komisionit.
 2. znj. Valma Kamishi Zeka, Drejtoreshë në SH.F "Kelmend Rizvanolli" në Gjakovë, anëtar.
3. Anëtari i tretë i këtij Komisioni zgjidhet nga MASHTI, ashtu siç është paraparë në Rregulloren (QRK) nr.19/2024 .
4. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.
5. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Drejtorisë për Arsim.
 - Anëtarëve të Komisionit.
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit



Shefqet Shehu

Kryesues i Kuvendit të Komunës